



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:159073
Datë: 20.05.2024
Numri i dokumentit: 05709793

C.nr.1468/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, divizioni civil, me gjyqtarin Shyqri Hoxha dhe bashkëpunëtorin profesionale H.D. në çështjen juridike kontestimore të paditësve J.G. dhe E.G. të dy nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson E.Gj. avokate nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike në Kosovë, Sh. A (KEDS), me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson G.H. për shkak të kompensimit të dëmit jo material, vlera e kontestit 15,200.00 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor - publik, në prani të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse me datë 04 Prill 2024 mori, ndërsa më datë 20 Maj 2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZHET kërkesëpadia e paditësve J.G. dhe E.G. të dy nga Prizreni, me të cilën kanë kërkuar që të *“DETYROHET e paditura Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike në Kosovë, Sh. A (KEDS), me seli në Prishtinë, që paditësve të ia kompensoi dëmin e shkaktuar material dhe jo material në shumën prej 15.200euro, me normën e kamatës prej që paguajnë bankat klienteles së vetë, në mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të posaçëm, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit e deri te pagesat definitive ”*, **në tërësi si e pabazuar.**

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

1. *Pretendimet e palëve ndërgjyqëse*

Paditësit J.G. dhe E.G. të dy nga Prizreni, përmes të autorizuarës së tyre E.Gj. avokate nga Prizreni, me datën 19.07.2021, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar padi, të cilën e kanë precizuar në shqyrtimin e datës 16.01.2023, kundër të paditurës Kompania

Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike në Kosovë, Sh. A (KEDS), me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit jo material, vlera e kontestit 15,200.00 €.

Në padinë e paraqitur e autorizuar e paditëses ka theksuar se me datë 05.02.2018, rreth orës 18:55 min, në rr. "Fahredin Hoti" p.nr., ka ndodhur një rast zjarri, nga i cili paditësit kanë pësuar dëme, ku i janë djegur teshat, mobiljet, paisjet që kanë qenë në katin e dytë ku kanë jetuar, duke shkaktuar dëme në vlerë rreth 10,000.00 euro. Si pasojë e këtij zjarri, paditësja ka pësuar edhe trauma, e si rezultat i të cilave është detyruar të shërohet në Turqi. Andaj gjykatës i ka propozuar që pas administrimit të provave të merr vendim dhe kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

E autorizuar e paditësve edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë kërkesëpadisë, ndërsa në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim në seancën e datës 04.04.2024, e autorizuar e paditësve ka deklaruar se nga provat e administruara është vërtetuar fakti se në ditën kritike me datë 05.02.2018, në tërësi është djegur shtëpia e bashkëshortëve Julinda dhe E.G. ku në këtë fatkeqësi paditësit kanë pësuar dëme të mëdhaja. Andaj, gjykatës i ka propozuar që të aprovon në tërësi kërkesëpadinë e paditësve.

Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

E paditura Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike në Kosovë, Sh. A (KEDS), me seli në Prishtinë, në përgjigjen në padi të datës 19.07.2022, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si nga baza ashtu edhe nga lartësia, duke i propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të refuzon në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar.

E autorizuar e të paditurës edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka qëndruar në tërësi pranë përgjigjes në padi, duke e kontestuar kërkesëpadinë e paditësve. Ndërsa në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim në seancën e datës 04.04.2024, e autorizuar e paditësës ka theksuar se nga provat e administruara nuk është vërtetuar baza e po as lartësia e dëmit të kërkuar si në padi për vlerën 15,200.00. e njëjta ka shtuar se bazuar në nenin 136 të LMD, gjatë procedurës dhe provave të administruara nuk ka arritur që të vërtetohet fajësia e të paditurës KEDS Sh.A, për dëmin e pretenduar nga ana e paditësve. E po ashtu edhe sipas nenit 158 të LMD, ku në këtë rast është e qartë se dëmi nuk është shkaktuar nga veprimi ose mosveprimi i të paditurës KEDS Sh.A, sipas të cilës është liruar nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm apo nga veprimtaria e rrezikshme. Andaj, bazuar në të lartcekurat, konsideron se është vërtetuar se KEDS në këtë rast nuk është përgjegjëse dhe gjykatës i ka propozuar që padinë e paditësve ta refuzon në tërësi si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

2. Provat e administruara

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: ekspertizën e datës 13.11.2023, të punuar nga eksperti S.G. si dhe deklarin e ekspertit në shqyrtimin e datës 07.02.2024; dëgjimi i dëshmitarit E.D. në shqyrtimin e datës 19.03.2024; dëgjimi i dëshmitarit F.S. në shqyrtimin e datës 19.03.2024; dëgjimi i dëshmitarit Sh.S. në shqyrtimin e datës 19.03.2024; leximi i raportit mbi deklarin të rastit të dhënë në Polici me nr. 04-1/04-HEH-170/18, i datës 05.02.2018; leximi i vërtetimit të lëshuar nga Agjencia e menaxhimit Emergjent me nr. të referencës 02/2018, të datës 07.02.2018; procesverbalin për verifikimin e dëmit të konsumatorit me nr. 000537, të datës 07.02.2018; procesverbalin e intervistimit të viktimës me nr. të rastit 2018-GA-0241, i datës 05.02.2018; deklaratën e paditësit E.G. të dhënë në Policin e Kosovës me nr. të rastit 2018- GA-241, të datës 13.02.2018; kontratën mbi shitblerjen e palujtshmërisë LRP 469/2023, me nr. të referencës 114/2023, e lidhur tek noteri B.M. leximin e komunikimit përmes e-mailave të zyrtarit të KEDS, me datë 07 dhe 08 Korrik 2022; leximi i kërkesë së drejtuar nga pala paditëse E.G. për Kompaninë Keds me nr. të referencës 3266, me datë 13.02.2018; leximi i dosjes zyrtare nga Stacioni Policor në Prizren- njësia e krimeve kriminale me titullin rasti i mbyllur dërguar në Prokurorinë Themelore me nr. të rastit 2018- GA-0241, i datës 13.02.2018.

Gjykata pas vlerësimit të theksimeve të palëve dhe provave të administruara në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësve është e pa bazuar.

Nga leximi i ekspertizës së datës 13.11.2023, të punuar nga eksperti S.G. gjykata vërtetoi faktin se eksperti ka bërë përshkrimin e pajisjeve elektrike që e kanë furnizuar shtëpinë e paditësve me energji elektrike, shkaqet e shpërthimit të zjarrit në shtëpi, si dhe ka dhënë konstatimet se a ka qenë energjia elektrike në bazë të parametrave momental, shkaktare e zjarrit në shtyllë dhe njësor në shtëpinë e paditësve. Eksperti në ekspertizën e tij ka dhënë përfundimin se bazuar në të gjitha shënimet e ofruara, dëshmitë, deklaratën e pronarit, raportin e KEDS-it, raportin e Menaxhimit Emergjent MPB, shpërthimi i zjarrit ka ndodhur në dhomën ku është gjetur hekuri për hekurosje të rrobave. Eksperti ka dhënë mendim se shkaktar i shpërthimit të zjarrit ka mundur me qenë kabulli vazhdues, priza në mur apo nga vet hekuri për hekurosje të rrobave. Është konstatuar se nuk ka pasur ndonjë mbitension nga KEDS-i, ashtu që KEDS-si,

nuk është përgjegjës, sepse përgjegjësinë për instalimet e brendshme elektrike e mban pronari dhe personat të cilët bëjnë instalimet elektrike apo kompanitë.

Gjykata, në shqyrtimin e datës 07.02.2024, ka bërë dëgjimin e ekspertit S.G. i cili ka theksuar se me rastin e përpilimit të kësaj ekspertize është bazuar në të gjitha shkresat për lëndën në fjalë, ndërsa në vendin e ngjarjes nuk ka qenë për shkak se ka kaluar kohë e gjatë nga rasti. I njëjti ka theksuar se vendosja e kabllave nëntokësore ka përparësi shumë më të madhe se sa ajo ajrore, prandaj edhe dëmet nëse shkaktohen nga energjia elektrike në rrjet janë shumë të vogla, duke shtuar se nga ekspertiza e përpiluar mund të vërehet fotoja nr. 1, në faqen dy, ku shihet ormani elektrik me siguresa shkrirëse me 63 amperë, e ku nuk vërehet asnjë dëmtim i përçuesve apo i siguresave shkrirëse. Në bazë të ligjeve dhe rregulloreve që janë në fuqi të rregulluara nga rregullatori i energjisë, KEDS nuk mbanë përgjegjësi për instalimet elektrike pas njehsorit elektrik. Përgjegjësi për instalimet pas njehsorit elektrik bien në përgjegjësi të punë kryesit i cili ka bërë instalimin elektrik dhe pronarit të shtëpisë. Në faqe 3, foto 2, shihen dy njehsor elektrik që janë të vendosur në ormanin elektrik brenda objektit dhe nga kjo foto shihet se nuk ka pasur ndonjë dëmtim të përçuesve apo kabllor elektrike deri te njehsorë, d.m.th., instalimi elektrik është dëmtuar pas njehsorit elektrik.

Gjykata në shqyrtimin e datës 19.03.2024, ka bërë dëgjimin e dëshmitarit E.D. punëtor pranë të paditurës KEDS, i cili pranë kësaj gjykate ka deklaruar se: pas marrjes së informatës për rastin e ndodhur, djegien e shtëpisë më saktësisht të katit të dytë, ka qenë pjesëmarrës në komisionin për verifikimin e dëmit të palëve, duke theksuar se qëndron në tersi pranë përmbajtës së procesverbalit me nr. 000537, të datës 07.02.2018. I njëjti ka theksuar se prej verifikimit të tyre, kanë vërejtur që zjarri ka ndodhur në katin e dytë të objektit, ku dhe shkaktar i zjarrit ka qenë prej instalimit të brendshëm, kjo pasi që deri në pikën matëse-njehsori gjithçka ka qenë brenda normave teknike. Në momentin e verifikimit brenda në shtëpi ka vërejtur se një hekur për hekurosje ka qenë afër prizës, ku ka qenë i djegur në tersi kabllor e hekurit së bashku me prizën.

Gjykata në shqyrtimin e datës 19.03.2024, ka bërë dëgjimin e dëshmitarit F.S. punëtor pranë të paditurës KEDS, i cili pranë kësaj gjykate ka deklaruar se: qëndron në tërësi pranë procesverbalit me nr. 000537, të datës 07.02.2018, ku ka qenë pjesë e komisionit për vlerësimin e dëmit, duke sqaruar se në ditën e inspektimit kanë shkuar në vendin e ngjarjes, janë takuar me pronarin të cilit i kanë drejtuar në zonën ku ka ndodhur zjarri, gjegjësisht në katin e dytë, në një dhomë ku ka shpërthyer zjarri tek prizat. Ku gjatë hulumtimeve të cilat i bëjnë në të gjitha rastet, edhe në këtë rast duke e lokalizuar burimin e zjarrit. Aty ka qenë një kabllor vazhduese në të cilën ka qenë e vendosur një hekur për hekurosje, i cili ka qenë i kyçur mirëpo është dëmtuar pjesa e burimit të energjisë, pozicioni i hekurit ka qenë në formë të rrëzuar ku pjesa e hekurit që hekuros ka qenë në kontakt me dyshemesë. Njehsori elektrik apo Ormani

kabllovik shpërndarës, kanë qenë në rregullt dhe të pa dëmtuar. Në ditën e inspektimit kanë kontaktuar me pronarin e shtëpisë E.G. ku fillimisht tek secila palë kur kontaktojnë fillimisht e marrim një deklaratë nga ana e tyre lidhur me rastin, ku përfshihet në procesverbalin e inspektimit, ku dy rubrika i takojnë konsumatorit, njëri lidhur me rastin e ndodhur dhe tjetri me dëmet që pretendohet nga pala. Zakonisht procesverbali i lexohet palës, nënshkruhet dhe një kopje i lihet palës, ku në rastin konkret nga procesverbali vërtetohet se është nënshkruar dhe një kopje iu është lënë palës.

Gjykata në shqyrtimin e datës 19.03.2024, ka bërë dëgjimin e dëshmitarit S.S. punëtor pranë të paditurës KEDS, i cili pranë kësaj gjykate ka deklaruar se: qëndron në tërësi pranë procesverbalit me nr. 000537, të datës 07.02.2018, ku ka qenë pjesë e komisionit për vlerësimin e dëmit, ndonjë konstatim të saktë nga çka ka ardhur zjarri nuk kanë mundur të konstatojnë, por nga inspektimi kanë konstatuar se deri në pikën matëse-njehsorit, i cili ka qenë i vendosur në katin e parë të objektit, ndërsa vatra e zjarrit ka qenë në katin e dytë dhe kanë ardhur në përfundim se deri në pikën matëse rrjeti ka qenë i pa dëmtuar, ndërsa zjarri ka mundur të ndodh nga një faktor i jashtëm apo nga instalimi i brendshëm.

Nga leximi i raportit mbi deklarinimit të rastit të dhënë në Polici me nr. 04-1/04-HEH-170/18, i datës 05.02.2018, gjykata vërtetoi faktin se këtu paditësi E.G. kishte raportuar rastin në polici "Incident i Zjarrit" me numër të rastit 2018-GA-0241, me ç'rast të njëjtit i ishte shkaktuar dëm material.

Nga leximi i vërtetimit të lëshuar nga Agjencia e menaxhimit Emergjent me nr. të referencës 02/2018, të datës 07.02.2018, gjykata vërtetoi faktin se me datë 05.02.2018, rreth orës 18:30 min, kishte ardhur deri te shpërthimi i zjarrit në shtëpinë private të E.G. nga Prizreni, e cila gjendet në rrugën F.H. p.nr., në Prizren. Në intervenimin për shuarjen e zjarrit kanë marrë pjesë Brigada Zjarrfikëse nga Prizreni dhe nga ky zjarre është djegur kati i dytë i kësaj shtëpie.

Gjykata ka bërë leximin e procesverbalin për verifikimin e dëmit të konsumatorit me nr. 000537, të datës 07.02.2018, nga i cili janë konstatuar dëmet/pajisjet e dëmtuara në shtëpinë e këtu paditësve si pasojë e zjarrit.

Nga leximi i procesverbalit të intervistimit të viktimës me nr. të rastit 2018-GA-0241, i datës 05.02.2018 dhe deklaratës së paditësit E.G. të dhënë në Policin e Kosovës me nr. të rastit 2018- GA-241, të datës 13.02.2018, gjykata vërtetoi faktin se këtu paditësi E.G. në cilësinë e viktimës, kishte dhënë deklaratë pranë Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prizren, lidhur me rastin 2018-GA-0241, për djegien e shtëpisë së tij.

Nga leximi i kontratës mbi shitblerjen e palujtshmërisë LRP 469/2023, me nr. të referencës 114/2023, e lidhur tek noteri B.M. gjykata vërtetoi faktin se me datë 13.01.2023, ishte lidhur kontratë në mes të L.T. në cilësinë e shitësit dhe këtu paditësit E.G. në cilësinë e blerësit, ndërsa objekt i kësaj kontrate është pjesa ideale prej ½, e paluajtshmërisë e evidentuar si njësi kadastrale me numër P-71813068-.....

Nga leximi i komunikimit përmes e-mailave të zyrtarit të KEDS, me datë 07 dhe 08 Korrik 2022, gjykata konstatoi faktin se të njëjtat paraqesin komunikimet e bëra në mes të zyrtarëve pranë këtu të paditurës KEDS.

Nga leximi i kërkesë së drejtuar nga pala paditëse E.G. për Kompaninë KEDS me nr. të referencës 3266, me datë 13.02.2018, gjykata vërtetoi faktin se paditësi i ishte drejtuar të paditurës me kërkesë që e njëjta të konstatonte problemin, shkakun dhe dëmin që i ishte shkaktuar nga rryma elektrike.

Nga leximi i dosjes zyrtare nga Stacioni Policor në Prizren- njësi e krimeve kriminale me titullin rasti i mbyllur dërguar në Prokurorinë Themelore me nr. të rastit 2018- GA-0241, i datës 13.02.2018, gjykata konstatoi faktin se i njëjti paraqet rrjedhën e rastit, të paraqitur për zjarrin e ndodhur me datë 05.02.2018, në shtëpinë e këtu paditësve.

3. Baza Ligjore

Gjykata vlerëson se në këtë çështje kontestimore gjen zbatim Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve 04/L-007, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20.12.2012.

Neni 136 i Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve (LMD), në par.1 të tij përcakton se: *“Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*, neni 137 i po këtij ligji përcakton: *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).”*, neni 140 i këtij ligji përcakton: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia”*. Në Kodin e Shpërndarjes, e cila është rregullore e brendshme e këtu të paditurës, në nenin 4.5.3.3 është paraparë se *“Për furnizimet e TU përgjegjësia e OSSh-së zgjerohet deri tek pika e kyçjes së konsumatorit e cila normalisht është: a) Pikat dalëse të daljet e TMRR-ve (L) dhe hyrja në ndërprerësin kryesor tek furnizimi i konsumatorit. b) Te objektet afariste dhe të amvisërisë: në Pikën e Kyçjes në pjesën dalëse të njehsorit.”*

4. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Duke marrë parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse, provat e administruara më lartë në lidhje me këtë çështje kontestimore dhe dispozitat e

lartcekura ligjore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e pa bazuar dhe se e njëjta duhet të refuzohet, sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ishte kontestuese se me datë 05.02.2018, rreth orës 18.55 min, në rrugën F.H. përkatësisht në shtëpinë e këtu paditësve ka ardhur deri tek shpërthimi i zjarrit, si pasojë e të cilës është djegur kati i dytë i shtëpisë. Kontestuese në këtë çështje juridike ishte se a ishte e paditura Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike në Kosovë, Sh. A (KEDS), me seli në Prishtinë, përgjegjëse në shkaktimin e këtij zjarri dhe konform dispozitave ligjore a është përgjegjëse për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga zjarri në shtëpinë e paditësve.

Gjykata, vlerëson se në këtë çështje kontestimore, baza juridike e kërkesëpadisë nuk gjen mbështetje në nenin 136 par.1 dhe 140 të LMD-së, për arsye se dëm konsiderohet vetëm dëmi i cili si i tillë pranohet nga e drejta. Kështu dëmi përfaqëson dëmtimin që pëson një person i caktuar në të mirën juridike që mund të jetë personale dhe pasurore, me kusht që ato të jenë juridikisht të mbrojtura. Nga vetë përmbajtja e nenit 136 par.1 të LMD-së, rezulton se ai që i shkakton dëm tjetrit ka për detyrim t'ia shpërblejë atë. Për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit është e nevojshme që të jetë shkaktuar dëmi, të dihet shkaktari i tij dhe të ekzistojnë parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit mbi bazën e fajësisë apo mbi ndonjë bazë tjetër ligjore. Për të ekzistuar detyrimi për kompensimin e dëmit duhet të plotësohen këto parakushte: a) të shkaktohet dëmi; b) që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin/mosveprimin e kundërligjshëm; c) të ekzistojë faji i dëmtuesit; d) që të ekzistojë aftësia deliktore dhe e) të ekzistojë lidhja kauzale ndërmjet veprimit/mosveprimit të kundërligjshëm dhe dëmit. Në rastin konkret nuk janë plotësuar parakushtet ligjore për të ekzistuar përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit këtu paditësve.

Lidhur me përgjegjësin e të paditurës në këtë çështje kontestimore gjykata ka aprovuar kërkesën e paditësve për nxjerrjen e ekspertizës së elektroenergjetikës. Nga leximi i ekspertizës së datës 14.11.2023, të punuar nga eksperti S.G. gjykata vërtetoi faktin se shpërthimi i zjarrit në shtëpinë e paditësve kishte ndodhur në dhomën në të cilën ishte gjetur hekuri për hekurosje të rrobave dhe se shkaktar i shpërthimit të zjarrit ka mundur të jetë kabulli vazhdues, priza në mur apo vet hekuri për hekurosjen e rrobave dhe nuk ka pasur ndonjë mbi tension nga Keds. Po ashtu nga kjo ekspertizë gjykata ka vërtetuar faktin se e paditura Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike në Kosovë, Sh. A (KEDS), me seli në Prishtinë, nuk është përgjegjëse për shkaktimin e zjarrit në shtëpinë e këtu të paditurve, pasi që përgjegjësinë për instalimet e brendshme elektrike i mban pronari dhe personat që bëjnë instalimet elektrike apo kompanitë. Gjykata vlerëson se ekspertiza e lartcekur është e plotë, e njëjta është përpiluar në mënyrë profesionale dhe është në përputhje

edhe me provat e tjera të administruara në këtë çështje juridike kontestimore, për çka edhe gjykata ia fali besimin e plotë, sa i përket mos përgjegjesisë së këtu të paditurës për kompensimin e dëmit këtu të paditurve.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore ka bërë edhe dëgjimin e dëshmitarëve, të cilët kanë qenë anëtar të komisionit në procesverbalin për verifikimin e dëmit me numër 000537, të datës 07.12.2018. dëshmitari E.D. pranë kësaj gjykate në deklarin e tij, ndër të tjera ka deklaruar se: *prej verifikimit tonë, ne kemi vërejtur që zjarri ka ndodhur në katin e dytë të objektit, ku dhe shkaktar i zjarrit ka qenë prej instalimit të brendshëm, arsyeja pse po e them këtë deri në pikën matëse-njehsori gjithçka ka qenë brenda normave teknike. Në momentin e verifikimit brenda në shtëpi kam vërejtur se një hekur për hekurosje ka qenë afër prizës, ku ka qenë i djegur në tersi kabllo e hekurit së bashku me prizën. Ngjashëm ka deklaruar edhe dëshmitari F.S. i cili ka theksuar se: në ditën e inspektimit kemi shkuar në vendin e ngjarjes jemi takuar me pronarin të cilit na kanë drejtuar në zonën ku ka ndodhur zjarri, gjegjësisht në katin e dytë në një dhomë ku ka shpërthyer zjarri tek prizat. Ku gjatë hulumtimeve të cilat ne i bëjmë në të gjitha rastet edhe në këtë rast duke e lokalizuar burimin e zjarrit. Aty ka qenë një kabllo vazhduese në të cilën ka qenë e vendosur një hekur për hekurosje, i cili ka qenë i kyçur mirëpo është dëmtuar pjesa e burimit të energjisë, pozicioni i hekurit ka qenë në formë të rrëzuar ku pjesa e hekurit që hekuros ka qenë në kontakt me dyshemenë. Njehsori elektrik apo Ormani kabllovik shpërndarës, kanë qenë në rregullt dhe të pa dëmtuar. Ndërsa dëshmitari Sh.S. pranë kësaj gjykate ka deklaruar se: ne nga inspektimi kemi konstatuar deri në pikën matëse- njehsorit i cili ka qenë i vendosur në katin e parë të objektit, ndërsa vatra e zjarrit ka qenë katin e dytë dhe kemi ardhur në përfundim se deri në pikën matëse rrjeti ka qenë i pa dëmtuar, ndërsa zjarri ka mundur të ndodh nga një faktor i jashtëm apo nga instalimi i brendshëm. Deklarimeve të këtyre dëshmitarëve gjykata ia fali besimin e plotë, pasi që të njëjtat janë në përputhje me njëra tjetrën, dëshmitarët kanë qenë prezent në ditën e shkaktimit të zjarrit dhe kanë bërë konstatimet e tyre pas verifikimit të shtëpisë së këtu paditësve, po ashtu deklaratat e tyre janë në përputhje edhe me provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës.*

Bazuar në të lartcekurat, si dhe nga provat e administruara dhe të vlerësuara, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësve është në tërësi e pathemeltë, andaj të njëjtën e refuzoi si të pabazuar. Kjo për faktin se me asnjë provë nuk është vërtetuar se e paditura është përgjegjëse për shkaktimin e zjarrit në shtëpinë e këtu paditësve, pasi që nga ekspertiza e ekspertit të energjetikës, është gjetur se zjarri në shtëpinë e palëve paditëse nuk ka rrjedhur nga instalimet elektrike ku gjendet njehsori elektrik, pasi që ormani me njehsorin që është i vendosur në shtëpi, nga ku furnizohet me energji elektrike shtëpia e paditësve është i padëmtuar, por që duke u bazuar nga ekspertiza si dhe dëshmitë e dëshmitarëve është vërtetuar fakti, zjarri ka rrjedhur nga pjesa e brendshme e shtëpisë, e i cili zjarr ka mundur të rrjedhë nga vendi ku është gjetur hekuri për hekurosje. Andaj duke u bazuar në rregullativën ligjore që e rregullon fushën e energjetikës në Republikën e Kosovës, e sidomos në Kodin e shpërndarjes,

gjkata vërtetoi faktin se kufiri ndarës i përgjegjësisë së të paditurës në raport me dëmin e ndodhur, është tek pika e kyqjës së konsumatorit me energji elektrike, e që në rastin konkret paraqitet njehsori e elektrik ndërsa prej kyqjes në njehsorin elektrik përgjegjësia lidhur me instalimin e rjetit elektrik si dhe dëmët që mund të rrjedhin nga ky instalim i bart pronari i shtëpisë. Në bazë të nenit 7 par. 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, është paparaparë që *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”* ndërsa neni 319.1 parasheh që *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*. Kjo do të nënkuptonte se barra e të provuarit për realizimin e kërkesës për dëmshpërblim bie mbi paditësit. E në rastin konkret paditësit nuk kanë arritur që të argumentojnë faktin se përgjegjës për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga shpërthimi i zjarrit në shtëpinë e paditësve është këtu e paditura.

Gjkata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të administruara në shqyrtimin kryesor, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike-kontestimore.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata e morri në bazë të nenit 450 dhe nenit 463 par.1 të LPK-së, pasi që e paditura nuk i kanë kërkuar shpenzimet procedurale.

Nga të cekurat më lartë dhe bazuar në nenet 136, 137 dhe 140 të LMD-së, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
C.nr.1468/2021, datë 20 Maj 2024

G j y q t a r i

Shyqri Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.